

P.nr.731/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i përgjithshëm përmes gjyqtarit, *Islam Thaçi* me procesmbajtësen *Rafete Syla*, në lëndën penale kundër të pandehurit *L. M.*, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i shenjave nga neni 414 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan PP.II.nr.1044/16 të dt. 10.06.2016 dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor- dënim me gjobë, me datën 06.06.2017, jashtë shqyrtimit gjyqësor, mori këtë

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PSH. në Gjilan PP.II.nr.1044/16 të dt. 10.06.2016,, për dhënien e **urdhrit ndëshkimor**,

Kundër të pandehurit **L. M** nga Gj . i lindur më dt. ...u edhe jeton..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili është

Ë s h t ë f a j t o r

S e p s e

Më datën 15 janar 2015, në kohë të pa caktuar në shtëpinë e konsumatorit *G. C* në rrugën *Q* në Gj është konstatuar se i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike ka hequr dhe dëmtuar bllokbën zyrtare me nr. ... vendosur në njehsorin elektrik me nr.më...2015 nga personat e autorizuar të *KEDS-it*, për shkak të mos pagesës së borxhit, ndërsa i njëjti bllokbën zyrtare të vendosur, e dëmton e hap dhe rilidhet në rrjetin elektrik, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta pa autorizim dhe pa e përmbushur borxhin që kishte ndaj kompanisë për furnizim me energji elektrike..., vazhdon më tutje të furnizohet me energji elektrike.

- me këtë ka kryer veprën penale, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në këto dispozita ligjore të nenit 4,7,41,46 të KPRK-se, si dhe neneve 495 dhe 365 paragrafi 1.nenparagrafi 1.1 të KPPK-ës, të pandehurit, i

SH Q I P T O N

Dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqindpesëdhjetë)Euro, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj , nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk donë t'ia paguaj gjobën, atëherë denimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim , duke iu llogaritur 20 € të dënimit me gjobë me një ditë burgim .

Detyrohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale - paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmerisë të këtij aktgjykimi.

E dëmtuara..., për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjilan, ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1044/16 të dt. 10.06.2016, kundër të pandehuri ,për shkak të veprës penale, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par. 1 të KPRK-së .

Gjyqëtari pas shqyrtimit të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimore, për shqiptimin e dënimit me gjobë dhe provave të bashkangjitura kërkesës së PSH. në Gjilan, vërtetoi se kërkesa lëndore duhet të pranohet, sepse provat e bashkangjitura aktakuzës, ofrojnë fakte relevante të mjaftueshme për aprovimin e saj pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, në pajtim me nenet 493 dhe 495 të KPPK.

Pas vlerësimit nga ana e gjykates të të dhënave në kallximin penal, si dhe shkresat tjera, është vërtetuar se i pandehuri..., e ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par. 1 të KPRK-së . në mënyrën e pershkruar ne dispozitivin e ketij aktgjykimi.

Kjo gjendje faktike e pa kontetueshme rezulton se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e vepres penale, te pershkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi . Prandaj gjykata për këtë veper penale e shpalli fajtor dhe penalisht përgjegjëse, dhe e ka dënuar sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartsinë e dënimit , gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 74 të KPRK.-ës . Prandaj gjykata ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qellimi dënimit nga neni 41 të KPRK.

E dëmtuara-...., Konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

I pandehurin detyrohet që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale - paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €. në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë në pajtim me nenin 453 parag.1 të Kodit të Procedurës Penale, të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i pergjithshem
P.nr.731/16, më 06.06.2017

Sek.juridike,
Rafete Syla,d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Islam Thaçi,d.v.

UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: *Kundër këtij aktgjykimi –urdhri ndëshkimor, i pandehuri , mund të ushtrojnë, kundërshtim në këtë gjykatë , në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit , në kopje të mjaftueshme. Mirëpo në këtë rast ,gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet me kërkesën e prokurorit të shtetit nga neni 493 dhe as me ndalesën nga neni 395 të këtij kodi.*